



ÇFARË ARME POSEDOJ?



SAFETY MATTERS
SIGURIA MBI TË GJITHA
SIGURNOST PRE SVEGA



QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRA E PUNËVE TË MBRENDSHME

Mbështetur nga: UNDP,
Qeveria e Belgjikës, Qeveria e Danimarkës, Qeveria e Luksemburgut,
Qeveria e Holandës dhe Qeveria e Suedisë.

Kat	Përshkrimi
A1	Predhat shpërthyesë ushtarake dhe sistemet lansuese
A2	Armët automatike
A3	Armët e maskuara si objekte tjera
A4	Municioni me nivel të lartë të shpimit, municioni shpërthyes ose predhat zjarrvënëse dhe predhat për municion të tillë
A5	Municion për pistoleta dhe revolverë përfshirë ose jo plumbat dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjueti ose për qitje të personave që kanë të drejtën e përdorimit të tyre
A6	Armët me shurdhues të montuar
A7	Armët me tytë me vjaska dhe kalibër mbi 12,7 milimetra
A8	Armë gjysmë automatike për përdorim civil që i ngjajnë armëve automatike
A9	Eksplzivët dhe pjesët e tyre
A10	Armët për përdorim të gazrave dhe municioni i tyre
A11	Pajisjet e veçanta për armët e zjarrit
A12	Armët elektroshok
A13	Municioni gjurmues
A14	Municioni me veprim të dyfishtë
A15	Municioni 5.7 x 28 mm SS 190
A16	Armët me energji të drejtpërdrejtë
A17	Armët me tytë poligonale

Armët në kategorinë A nuk mund të posedohen, legalizohen e as të çaktivizohen

Mundësia e vetme është dorëzimi i tyre në stacionin lokal të policisë!

Shitja dhe posedimi i këtyre llojeve të armëve është shkelje penale.

Armë e shkurtër

Tyta < 30 Cm



Armë e gjatë

Tyta > 30 Cm



Gjatësi e përgjithshme < 60 cm

Gjatësi e përgjithshme > 60 cm

Kat	Përshkrimi
B1	Armë të shkurtra gjysmë automatike ose repetuese
B2	Armë e shkurtër me një qitje me perkusion për qitje qendrore
B3	Armë e shkurtër me një qitje me perkusion për qitje rrethore me gjatësi të përgjithshme nën 28 cm
B4	Armë e gjatë gjysmë automatike ku karikatori dhe foleja bashkë mund të mbajnë mbi tre fishekë
B5	Armë e gjatë gjysmë automatike ku karikatori dhe foleja bashkë mund të mbajnë gjer në tre fishekë, ku pajisja mbushëse mund të largohet ose mund të konvertohet me mjete të zakonshme në armë ku karikatori dhe foleja bashkë mund të mbajnë mbi tre fishekë
B6	Armë të gjata repetuese dhe gjysmë automatike me tytë pa vjaska që nuk tejkalon gjatësinë 60 cm
B7	Armë pneumatike me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm
C1	Armë të gjata repetuese, tjera nga ato në kategorinë B6
C2	Armë të gjata me vjaska me qitje të vetme
C3	Armë të gjata gjysmë automatike tjera nga ato të dhëna në B4, B5 dhe B6
C4	Armë me një qitje me perkusion për qitje rrethore me gjatësi të përgjithshme jo më pak se 28 cm
C5	Armë me një qitje me tytë pa vjaska
C6	Armë pneumatike me energji të predhës gjer në 7,5 J dhe kalibër gjer në 4,5 mm
C7	Armë për sinjalizim drite dhe akustike
C8	Adapterët
D1	Armët antike
D2	Armë me tejkë
D3	Armët e ftohta

Armët në kategorinë B,C dhe D mund të posedohen për qëllime gjuetie dhe sportive.

Këto armë mund të legalizohen ose çaktivizohen nëse pronari përgjegjës përmbushë kriteret e parashkruara në Ligjin për Armët.

Armë antike: nënkupton çdo armë me a ndezës, çark, kapak perkusioni, ose lloj tjetër të sistemit shkrepës i prodhuar në ose para vitit 1899

Armët me tejkë: janë harqet dhe mekanizmat tjerë, që funksionon nën presion të tejkës me tel dhe që gjuan shigjetën ose ndonjë predhë tjetër.

Armë automatike		nënkupton armën që rimbushet automatikisht çdoherë kur fisheku të jetë shkrepur, dhe mund të shkrepë më shumë se një fishek me një tërheqje të këmbëzës;
Armë gjysmë automatike		nënkupton armën që rimbushet automatikisht çdoherë kur fisheku të jetë shkrepur dhe mund të shkrepë një fishek me një tërheqje të këmbëzës;
Armë repetuese		nënkupton armën e cila pas shkrepjes së fishekut është e dizanuuar që të rimbushet nga karikatori ose cilindri përmes veprimit manual;
	Veprim të shulit	Arma me veprim të shulit është zakonisht pushkë ku hapja dhe mbyllja e folesë kontrollohet manualisht me shul.
	Veprim të levës	Arma me veprim të levës është zakonisht arma që përdorë levën e vendosur rreth mbrojtësit të këmbëzës (shpeshherë duke përfshirë edhe vet mbrojtësin) për të mbushur fishekët në fole të tytës kur leva të jetë hapur.
	Veprim të pompës	Pushka ose tekja (shotgun) me veprim pompe ka dorezën që pompohet prapa dhe përpara për të nxjerrë gëzhjojën dhe për të futur fishekun tjetër. Ajo është shumë më e shpejtë sesa pushka me veprim të shulit dhe paksa më e shpejtë sesa veprimi i levës, pasi që nuk kërkon që të largohet dora nga këmbëza gjatë mbushjes së armës. Kur përdoret në pushkë, ky veprim gjithashtu quhet edhe veprim me rrëshqitje .
Revolveri		Revolveri është armë me shumë qitje, zakonisht armë dore në të cilën foletë e shumta për qitje janë grupuar në një cilindër i cili rrotullohet për të sjellë çdo fishek vijues në një tytë të vetme.
Me një qitje		nënkupton armën pa karikator që mbushet para çdo qitjeje me futjen manuale të fishekut në fole ose në prerjen për mbushje në pjesën e prapme të tytës;
Shkrepje rrethore		Shkrepja rrethore është një lloj i fishekut të armës. Quhet qitje rrethore sepse gjilpëra shkrepëse në vend se të godet kapakun e mbushësit në qendër të bazës së fishekut për ta ndezur (sikurse te fishekët me shkrepje qendrore), gjilpëra godet skajin e bazës. Fisheku për shkrepje rrethore në të vërtetë është kapak perkusioni i zgjatur dhe i zgjeruar që përmban jo vetëm përbërjen ndezëse, por edhe barutin shtytës dhe predhën (plumbin).
Shkrepje qendrore		Fishek me shkrepje qendrore është fisheku në të cilin mbushësi është në qendër të kokës së gëzhjojës së fishekut. Përkundrejt fishekëve për shkrepje rrethore, mbushësi është komponent i ndarë dhe i zëvendësueshëm.
Tytë pa vjaska		Muri i tytës së tekës është më i hollë sesa i pushkës dhe sipërfaqja e brendshme e tytës është e lëmuar.
Tytë me vjaska		Pushka ka marrë emrin nga prezenca e ullukëve spiral në brendësi të tytës që quhen “vjaska.” Këta ullukë rrotullojnë fishekun e me këtë shton fushëveprimin dhe saktësinë e pushkës
Vjaskim poligonal		Vjaskimi poligonal është një lloj i vjaskimit ku hapësirat dhe ullukët zëvendësohen me “brigje dhe lugina” në formë poligonale rrethore, zakonisht si gjashtëkëndësh ose tetëkëndësh.